



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:095190

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05686953

**A.C.nr.3026/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Halide Reka, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, të cilin me autorizim e përfaqëson V.M, avokat me seli në Komuna Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.435/18 datë 10.03.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 14.05.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht** e themeltë ankesa e paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.435/18 datë 10.03.2021, dhe gjykohet si vijon: **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, **E BAZUAR. DETYROHET** e paditura Ministria e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës me seli në Komuna Prishtinë që paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, t'ia kompensoj dëmin material për automjetin xxx me targa të regjistrimit xxx, në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e datës 26.04.2018 në shumë prej 1,340.00 Euro (***njëmijëetreqindekatërdhjetëEuro***), me kamat prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

**II. DETYROHET** e paditura Ministria e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës me seli në Komuna Prishtinë që t'ia paguajë paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë në emër të shpenzimeve procedurale shumen prej 594 Euro, të gjitha këto

duhet t'i paguhen paditësit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbartimit me dhunë.

**III. Përtej shumës së gjykuar, për shpenzimet e procedurës kontestimore refuzohet si e pabazuar.**

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin C.nr.435/18 datë 10.03.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“... I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit S.S., nga Shkupi, Republika e Maqedonisë, me anë të së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Infrastrukturës së Republikës së Kosovës në Prishtinë që paditësit t’ia kompensoj shumën prej 1,340.00 Euro në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e datës 26.04.2018, me kamat prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 780.00 Euro.*

*II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”*

Kundër aktgjykimit C.nr.435/18 datë 10.03.2021, në afat ligjor paditësi, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

**- Ankesa e paditësit është pjesërisht e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi S.S., nga Shkupi, ka parashtruar në gjykatën e shkallës së parë padi kundër të paditurës Ministria e Infrastrukturës, Republika e Kosovës, për kompensimin e dëmit material.

Gjykata e shkallës së parë, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 10.03.2021, dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykim C.nr.435/18 datë 10.03.2021, me të cilin aktgjykim e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon “...*E paditura nuk ka kompetencë të menaxhimit të territorit ku ka ndodhur aksidenti dhe përkujdesjes ndaj qenëve endacak dhe për këto arsye nuk ka përgjegjësi civile (subjektive apo objektive). Në nenin 163 të LMD-ës parashihet “1. Zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj. 2. Zotëruesi i kafshës shtëpiake është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka treguar kujdesin dhe mbikëqyrjen e nevojshme”. Nga kjo shihet se për të pasur përgjegjësi objektive e paditura duhet të ketë zotërimin apo detyrën për përkujdesje ndaj qenëve endacak në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, e që në rastin konkret nuk e kemi...”.*

Vlerësimin juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuar në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 195 par.1, pika e), e Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar duke konsideruar se nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike, dhe është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale, dhe atë duke u bazuar në ekspertizën, dhe mendimin e ekspertit të trafikut rrugor NSH “Ekspertiza” Ferizaj, i cili ekspert në ekspertizën e punuar me datë 20.11.2020 ndër të tjera ka konstatuar se “... *Se aksidenti i shkaktuar në pjesën e autoudhës, ka ndodhur për shkak të daljes së befasishme të qenit nga rrethojat ndarëse të shiritave rrugor... kjo ka ardhur për shkak të lëshimeve të subjektit të autorizuar për mirëmbajtjen e autoudhës, lëshime këto që kanë ndikuar në krijimin e situatës së rrezikshme, për shkak se pjesa e rrugës ku ka ndodhur aksidenti i trafikut është rrugë e destinuar për lëvizjen e automjeteve motorike...Duke qenë e tillë autoudha duhet të sigurojë që qarkullimi i automjeteve të bëhet i pa penguar... po ashtu duhet të jetë e siguruar që të pamundësohet hyrja në të e kafshëve...”.*

Në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive thuhet se “*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”.*

Gjykata e Apelit sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit është bazuar në ekspertizën e vlerësimit të dëmit material nr.3 datë 15.02.2021 të punuar nga eksperti F.G.H., i cili ekspertë në ekspertizë ndër të tjera ko konstatuar se “*Në bazë të analizimit të vlerës së dëmit material në automjetin : xxx, ... vijë në konstatim se në aksidentin e datës : 26/04/2018 është shkaktuar dëmë material nga kafsha (qeni) Në vlerë 1.340.00 €...”.*

Në nenin 174 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decidive thuhet se *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*.

Gjykata e Apelit ka vendosur edhe për shpenzimet procedurale, pasi që paditësi i ka kërkuar shpenzimet procedurale të specifikuara gjatë shqyrtimit të kësaj procedure kontestimore në shkallen e parë, si dhe duke u bazuar në nenin 452. par.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“...Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqëfituese,..., t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore...”*, si dhe bazuar në nenin 452.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“... Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve...”* dhe nenit/ve 6, dhe 7 të Rregullores për tarifat e avokatëve, duke e obliguar të paditurin që paditësit t’ia paguajë vetëm pjesën procedurale dhe të domosdoshme të shpenzimeve procedurale për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe atë për seancat gjyqësore të mbajtura në Gjykatën e shkallës së parë me datë 11.11.2020, 22.01.2021, në shumë prej 270 Euro, ndërsa për përpilimin e padisë shuma prej 104 Euro, për shpenzimet e dy ekspertizave në shumë prej 200 Euro, për taksë gjyqësore 20Euro, e të gjitha në shumën prej 594 Euro, ndërsa është refuzuar përtej shumës së gjykuar, si e pa bazuar.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195 par.1, pika e), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.3026/2021 datë 14.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**